

VENDIM
Nr.691, datë 21.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
BASHKIA PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Përrenjas të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 7 (shtatë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Përrenjas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTESHME SHETËTËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit pyje, kullota, livadhe, shkëmbore, etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Bashkia: Përrenjas										
Nr.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike PPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
1		2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	496	EP Përrenjas	Rashtan	1/a	Pyll	53.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	
2	497	EP Përrenjas	Gerbunje	98/a	Pyll	28.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	
3	498	EP Përrenjas	Gerbunje	98/b	Pyll	44.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	
4	499	EP Përrenjas	Gerbunje	99/a	Pyll	51.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	
5	500	EP Përrenjas	Gerbunje	100/a	Pyll	33.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	
6	501	EP Përrenjas	Gerbunje	101/a	Pyll	14.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	
7	502	EP Përrenjas	Gerbunje	101/b	Pyll	16.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	B. Përrenjas	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
496 - 502.	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi